



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Pml.nr.776/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar, Rasim Rasimi dhe Mejreme Memaj, anëtare, me bashkëpunëtorin profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit R. S. nga P., për shkak të veprës penale dhunimi nga neni 227 paragrafi 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të ushtruar nga Prokurori i Shtetit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.291/23 të datës 20.03.2024 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës- Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr.251/24 të datës 04.09.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 16.01.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit, e paraqitur kundër aktgjykimit të Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.291/23 të datës 20.03.2024 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës- Departamenti për Krime të Rënda PAKR.nr.251/24 të datës 04.09.2024.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda me aktgjykimin PKR.nr.291/2023 të datës 20.03.2024, të akuzuarin R. S., në kuptim të nenit 363 paragrafi 1 pika 1.3 të KPP-së, e ka liruar nga akuza për veprën penale dhunimi nga neni 227 paragrafi 1 të KPRK, pasi që nuk është provuar se e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Shpenzimet e procedurës penale bijën në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës. Pala e dëmtuar A. B., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin PAKR.nr.251/24 datë 04.09.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Ankesën e përfaqësueses së palës së dëmtuar A. B. e ka hudhur si të palejuar, sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori i Shtetit, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës kërkesën ta aprovoj si të bazuar dhe të konstatoj se aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit R. S. avokati Skender Musa, me propozim që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit të refuzohet si e pabazuar ndërsa të vërtetohen aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435 paragrafi 1 lidhur me nenin 436 paragrafi 1 të KPP-së dhe pasi i vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar.

Prokurori i Shtetit në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë pretendon se, aktgjykimet e kundërshtuara janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për faktin se të njëjtat nuk paraqesin ndonjë vlerësim dhe analizë konkrete se pse në veprimet e të pandehurit nuk janë konsumuar elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar.

Më tutje në kërkesë theksohet se të dy gjykatat kanë vepruar në kundërshtim me nenin 369 paragrafi 6 dhe 7 të KPP-së, duke mos paraqitur arsye të qarta për çdo pikë të arsyetimit, nuk kanë paraqitur qartë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i ka konsideruar të vërtetuara apo të pavërtetuara. Theksohet se gjykata nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme se veprimet e të akuzuarit nuk përbëjnë veprë penale, nuk ka dhënë arsye se si ka ndodhur akti seksual dhe gjendjen e rënduar shëndetësore dhe emocionale të dëmtuarës. Pretendohet se me provat e administruara, deklaratën e të dëmtuarës, dëshminë e dëshmitares A. B. dhe provave tjera vërtetohet se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, ndërsa gjykatat me rastin e lirimit të akuzuarit nga akuza me aktgjykimet e tyre kanë bërë shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale e me këtë rast edhe shkeljen ligjit penal në dobi të akuzuarit.

Përgjigje në kërkesën e Prokurorit të Shtetit ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit, avokati Skender Musa, në të cilën përgjigje thekson se në kërkesën e Prokurorit të Shtetit nuk tregohet qartë se cilat dispozita të KPP-së, janë shkelur me marrjen e vendimit të gjykatës vetëm se është mjaftuar me atë se dy gjykatat nuk kanë hartuar aktgjykimet në pajtim me nenin 369 paragrafi 6 dhe 7 të KPP-së, prandaj i ka propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta të vërtetohen.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, pretendimet e Prokurorit të Shtetit të paraqitura në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, janë të pabazuara, meqenëse në rastin konkret nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për faktin se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë i kanë vlerësuar provat në pajtim me dispozitat e KPP-së, kurse lidhur me provat kontradiktore kanë dhënë arsytim në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye janë marrë si të provuara ose si të aprovuara, duke bërë vlerësimin e ligjshëm të tyre.

Gjykatat e instancës më të ulët e kanë bërë vlerësimin dhe analizën e të gjitha provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to kanë paraqitur konkludime të qarta, ndërsa faktet vendimtare të çështjes janë vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë. Qasja e tyre ndaj fakteve vendimtare ka qenë e drejtë dhe e ligjshme, sepse ka mbështetje në provat e administruara, kështu që asnjë fakt vendimtar në këtë çështje penalo-juridike nuk ka ngelur pa u arsyetuar sipas kërkesave ligjore.

Gjykata Supreme e Kosovës e pranon në tërësi qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë, të shprehur në aktgjykimet e tyre, përkitazi me pafajësinë e të akuzuarit R. S., duke gjetur se në veprimet e tij nuk manifestohen elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën akuzohet, meqenëse me asnjë provë nuk është vërtetuar se i dënuari ditën kritike, ta ketë kryer veprën penale për të cilën aktakuza e ngarkonte. Bazuar në shkresat e lëndës dhe në veçanti deklarimeve të vet palës së dëmtuar dhe dëgjimit të dëshmitarëve, nuk është vërtetuar se i pandehuri R. S. ka pasur marrëdhënie seksuale përkatësisht akt seksual me të dëmtuarën A. B.. E dëmtuara A. dhe nëna e saj A. kanë deklaruar se e dëmtuara fillimisht ishte trajtuar me gishta nga hoxha në organin gjenital për të hequr shejtanin nga mitra, por që një fakt të tillë gjykata nuk ka mundur ta vërtetojë me asnjë provë se i njëjti kishte aplikuar metoda të tilla për të shëruar të dëmtuarën, përveç faktit se i njëjti shërimin e saj e kishte bërë përmes lëshimit të ajeteve kuranore (ilahive) gjë për të cilën është vërtetuar edhe nga video incizimi i bërë nga vetë nëna e të dëmtuarës A. B., e cila përmes telefonit të saj mobil e kishte incizuar të dëmtuarën, ku në atë video incizim shihet e dëmtuara e shtrirë në një krevat duke dëgjuar thënie në gjuhën arabe dhe gjendja e saj shihet e qetë pa ndonjë shqetësim. Për më tepër nga ky video incizim nuk shihet se ndaj të dëmtuarës të jetë ushtruar dhunë, e kjo nuk është vërtetuar as nga ekspertiza mjekoligjore e bërë lidhur me këtë rast e gjithashtu edhe vet e dëmtuara në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se i akuzuari nuk ka përdor dhunë ndaj saj.

Kjo gjykatë vlerëson se, gjykata e shkallës së parë drejt kanë ardhur në përfundim se në rastin konkret me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën ka qenë i akuzuar, e po ashtu edhe gjykata e shkallës së dytë me rastin e vendosje s lidhur me ankesën e prokurorisë ka vepruar drejtë pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje materiale të cilat kishin me ndikuar në ligjshmërinë e vendimit të marrë.

Pretendimi i Prokurorisë së Shtetit për shkelje të ligjit penal, po ashtu është i pabazuar, për faktin se nuk është treguar se nga cilat fakte prokuroria konsideron si fakt të kryer dhunimin duke paragjykuar se e dëmtuara nuk ka dhënë pëlqimin për aktin seksual, gjë që është e pakuptueshme kur asnjëherë dhe me asnjë provë materiale e personale nuk është vërtetuar se ka ndodhur akti seksual i pretenduar nga prokuroria, sepse për të ekzistuar vepra penale nga neni 227 paragrafi 1 të KPRK, duhet që të ushtrohet dhunë dhe të detyrohet personi tjetër për të kryer akt seksual pa pëlqimin e personit të tillë, kurse në rastin konkret i akuzuari nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim të kundërligjshëm, por të gjitha veprimet i ka ndërmarre në pajtueshmëri me të dëmtuarën.

Kjo Gjykatë vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët me të drejtë kanë zbatuar dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të KPP-së, parimin in dubio pro reo, e cila dispozitë ka parashikuar se “mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.

Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartë cekura, si dhe rrethanat dhe arsyet më detajisht të theksuara në aktgjykimet e kundërshtuara, rezulton se konkludimet e gjykatave të instancës më të ulët se me provat e proceduara në seancën e shqyrtimit gjyqësor nuk mund të vërtetohet se i akuzuari R. S. ka kryer veprën penale të dhunimit nga neni 227 paragrafi 1 të KPRK, është i drejtë të cilin konkludim të gjykatave e mbështet edhe kjo Gjykatë.

Nga të gjitha këto që u theksuan më lart, u vendos si në dispozitiv të ktij aktgjykimi, e konform dispozitës së nenit 437 të KPP-së.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Pml.nr.776/24, më datë 16.01.2025

Procesmbajtës,
Sherif Krasniqi

Kryetar i kolegjit,
Afrim Shala